

PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS (SYLLABUSI)

Niveli: Bachelor Edukim Fizik dhe Sport

Lënda: Akrobatikë

Viti Akademik 2025/26

Viti i Studimeve: III

Semestri: V - Zgjedhore

Kreditet: 4 ECTS (European Credit Transfer and Accumulation System)

Ngarkesa: 2+1

Mësimdhënësi: Dr. Besim Halilaj

Kontakti: besim.halilaj@uni-pr.edu

Orari: E enjte, ora 15:05 – 16.25

Vendi: Salla e Gjymnastikës FEFS

Përmbajtja e Lëndës:

Lënda Akrobatika ka për qëllim që studentët të pajisen me informata teorike dhe demonstrimin e elementeve praktike në tapetin gjymnastikor. T'i përgatis studentët për demonstrimin e drejt të ushtrimeve dhe metodiken e të mësuarit të elementeve të Akrobatikës dhe të udhëheqin me procesin e mësimdhënies dhe stërvitor konform grupmoshave të caktuara.

Në mënyrë specifike lënda synon të:

- Të njohohen studentët lidhur me metodiken e të mësuarit të elementëve, asistimit dhe përvetësimin e demonstrimit sa më të mirë, lidhjen e elementëve të Akrobatikës dhe krijimin e kompozimeve.
- Të aftësoj studentët për të kuptuar ushtrimet e Akrobatikës sipas grupmoshave të ndryshme në shkollë dhe në klube sportive.
- T'i përgatis studentët që në mënyrë të pavarur ta hartojnë dhe udhëheqin një program stërvitor nga Akrobatika.

Qëllimi dhe rezultatet e pritura:

Pas përfundimit të kursit studenti pritet të dijë, kuptoj ose të jetë në gjendje të demonstroj:

Njohuri:

Të kuptoj nocionet dhe konceptet bazë nga Akrobatika.

Të identifikoj ushtrime nga Akrobatika dhe t'i përshkruaj ushtrimet saktë.

Të jetë në gjendje të demonstroj drejt elemente nga Akrobatika.

Të planifikoj dhe të udhëheq një proces stërvitor konform grupmoshave të ndryshme.

Shkathtësi:

Të jenë në gjendje të ndërlidhin njohuritë e fituara teorike dhe praktike për zhvillimin dhe zbatimin e programit të Akrobatikës sipas grupmoshave të caktuara.

Dëshmojnë aftësinë për klasifikimin e ushtrimeve në Akrobatikë dhe shpjegimin e ushtrimeve duke aplikuar edhe metodikën e të mësuarit.

Demonstrojnë aftësi për përdorim të metodave dhe teknologjive të reja për të strukturuar dhe zbatuar një plan stërvitorë me elemente të Akrobatikës me kategori dhe grupmosha të ndryshme.

Kompetenca:

Të jenë në gjendje të zbatojnë programe stërvitore të bazuar në nevojat e grupit specifik duke respektuar karakteristikat zhvillimore të grupit (kuptimi i karakteristikave biologjike- lëvizore, psikologjike, sociale).

Planifikon dhe zbaton ushtrime specifike (për forcë, lëvizshmëri, ekuilibër dhe koordinim) të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në realizimin e elementëve të Akrobatikës.

Janë në gjendje të aplikojnë analiza statistikore themelore specifike dhe mjete ndihmëse të teknologjisë së informacionit me qëllim të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për t'i përdorur në procesin e planifikimit dhe përcaktimit të ngarkesave në stërvitje.

Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:

Ligjerata, Mësimi praktik dhe ushtrime, punim seminarik dhe prezantim i punimit seminarik, punë individuale, detyra, grupe, etj.

Literatura: Mitchell, D., B. Davis & R. Lopez (2002). Teaching Fundamental Gymnastic Skills. Human Kinetics

- o Mamuti, F. (2012). *Akrobatika metodika e të mësuarit, Tetovë*.
- o Mamuti, F. (2012). *Gjymnastika Libri, Tetovë*.
- o Mamuti, F. (2013). *Gjymnastika mbi vegla metodika e të mësuarit, Tetovë*.
- o Federation Internationale De Gymnastique <https://www.gymnastics.sport/site/>
- o ACRO CoP 2025-2028 <https://www.gymnastics.sport/site/rules/#8>

Forma e vlerësimit:

Pjesëmarrja në ligjerata dhe përkushtimi – 20%, Seminari - 10%, praktika 40%, Vlerësimi teorik Final – 30%

Ps: Mungesa e plotësimit të kriterëve minimale nënkupton vlerën zero (0) në vlerësimin e vazhdueshëm.